

V E N D I M

Nr 30 Datë 15.12.2011

“Mbi faljen e detyrimeve të lindura nga aplikimi i normës së interesit”

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2011, mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Drejtoria Ekzekutive mbështetur në :

Ligjin Nr.9130, datë 08.09.2003,“Për Autoritetin Portual”, neni 8, neni 15 pika 2 dhe 18 pika ç dhe d, 24 pika 2, neni 27;

V.K.M. Nr. 596 datë. 10.09.2004 “Për Miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij”, neni 9 pika 1, neni 10 pika ç dhe d;

Vendimin e Këshillit Drejtues Nr 24 datë 15.03.2006 “Mbi Miratimin e Rregullores së Këshillit Drejtues të APD-së“, neni 16;

Me qëllim ndjekjen e politikës së faljes së detyrimeve të akumuluar deri në fund të vitit 2010, të lindura nga aplikimi i normës së interesit në APD ;

V e n d o s i:

1. Të falen pa pagesa shtesë, në favor të Autoritetit Portual Durrës :
 - a) Të gjitha detyrimet e rrjedhura nga aplikimi i normës së interesit sipas vendimeve të Këshillit Drejtues nr 84 date 28.12.2006 dhe vendimit nr 25 datë 17.09.2008 ndryshuar me vendimin nr 24 date 09.06.2008 dhe vendimin nr 30 datë 06.10.2010, të cilat rezultojnë të pashlyera deri më date 31.12.2010, dhe për të cilat subjektet kanë paguar detyrimet (principalin).
 - b) Të gjitha detyrimet të rrjedhura nga aplikimi i normës së interesit të përcaktuara në kontratat licencë të ngarkimit dhe shkarkimit, për operatorët e ngarkim shkarkimit, të cilat rezultojnë të pashlyera deri më datë 31.12.2010,dhe për të cilat subjektet kanë paguar detyrimet (principalin).

2. Falen kundrejt pagesës së detyrimit kryesor (totali i shumave të faturara nga APD kundrejt subjektit):
 - a) të gjitha detyrimet të rrjedhura sipas aplikimit të vendimeve të Këshillit Drejtues nr.84, i dt. 28.12.2006, nr 25 datë 17.09.2008 ndryshuar me vendimin nr 24 date 09.06.2008 dhe vendimin nr 30 datë 06.10.2010, të cilat rezultojnë të pashlyera deri më date 31.12.2010, dhe për të cilat nuk është paguar detyrimi kryesor.
 - b) Te gjitha detyrimet të rrjedhura nga aplikimi i normës së interesit të përcaktuara në kontratat licencë të Ngarkimit dhe shkarkimit, për operatorët e ngarkimi shkarkimit, të cilat rezultojnë të pashlyera deri më datë 31.12.2010, dhe për të cilat nuk është paguar detyrimi kryesor.
3. Të gjithë subjektet përfitojnë nga falja sipas pikës 1 këtij vendimi, me hyrjen e tij në fuqi të këtij vendimi.
4. Të gjithë subjektet përfitojnë nga falja sipas pikës 2 të këtij vendimi, në rast se kryejnë pagesën e të gjithë detyrimit kryesor (principalit të papaguar deri me datë 31.12.2010) brenda datës 30 Prill 2012.
5. Mbi detyrimet e arketuara sipas pikës 2 dhe 4 të këtij vendimi, nuk aplikohet komisioni 1 % i mbledhjes së të ardhurave.
6. Nga falja e parashikuar në këtë vendim, përfitojnë të gjithë subjektet fizike apo juridike të cilët rezultojnë debitorë për shuma të gjeneruara nga aplikimi i normave të interesit sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi.

Përjashtohet nga aplikimi i pikës 2/b të këtij vendimi, Operatori Liburnet-1 sh.p.k, trajtimi i detyrimeve të të cilit do të rregullohet në një vendim të vecantë.
7. Ngarkohet drejtoria Ekzekutive me ndjekjen e procedurave në zbatim të këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë nga publikimi.

Ervin MINAROLLI

Kryetar i Këshillit Drejtues